



FORUMI I GRUAS ELBASAN

PLAN STRATEGJIK

2008-2013

Korrik 2007

TABELA E PËRMBAJTJES

I. Hyrja/Përshëndetje nga presidente e FGE	fq. 1
II. Përmbledhja ekzekutive/e përgjithshme.....	fq. 2
III. Misioni dhe Vizioni.....	fq. 3
IV. Pikat unike të organizatës Forumi i Gruas Elbasan.....	fq. 7
V. Profili i Organizatës dhe historia e saj.....	fq. 7
VI. Drejtimet strategjike për të ardhmen.....	fq. 13
VII. Objektivat strategjik dhe plani i punës.....	fq. 15
VIII. Shtojca.....	fq. 23

I. Hyrje

Përshëndetje nga Presidentja e Forumit të Gruas Elbasan

Forumi i Gruas Elbasan është një shoqatë jofitimprurëse, joqeveritare që është krijuar në Gusht të vitit 1991. Është e para shoqatë e këtij lloji e krijuar në rrethin e Elbasanit menjëherë mbas ndryshimeve politike që ndodhën në vendin tonë .Fillimisht nuk dinim se çfarë janë Organizatat Jo Fitimprurëse, të sapo dala nga një regjim monist ku vetëm Bashkimi I Grave të Shqipërisë ekzistonte për të gjitha gratë shqiptare pavarësisht bindjeve politike, fetare edukimit etj. Fillimisht krijuan degën e Forumit të Pavarur të Gruas Shqipëtare (FPGSH) me gra nga të gjitha forcat politike.Mendimi në atë kohë ishte që të gjitha gratë të jenë të bashkuara në një organizatë të tyre pasi dhe hallet dhe problemet që ato kanë janë të njëjta dhe duke qenë të bashkuara me lehtë do ti zgjidhnin problemet e tyre.Por shumë shpejt u pa që kjo ide nuk ishte më e mira pasi partitë politike hap pas hapi filluan të krijonin organizatat e tyre politike të grave dhe shumica e grave të antarësuar në parti u shkeputën nga Forumi I Pavarur I Gruas Shqiptare dega Elbasan. Shumë gra të tjera megjithëse antare partie qëndruan dhe vazhdojnë edhe sot të jenë antare aktivë të Forumit të Gruas Elbasan. Duke qenë degë e FPGSH ne u përfshime dhe realizuam me sukses disa projekte kombëtare, sipas kushteve konkrete që kalonte vendi si furnizimi me një thes miell I 2500 familjeve në fshat dhe qytet, furnizimi me carcafë, batanije, bluza per personelin e spitalit psikiatrik etj

Me kalimin e kohës u diktua nevoja e të qënurit të pavarur Kështu që ne Janar të vitit 2000 Mbledhja e Pergjitheshme e Antarëve vendosi krijimin dhe regjistrimin në Gjykatën e rrethit Elbasan të Forumit të Gruas Elbasan (FGE), si subjekt I pavarur juridik dhe me vonë FGE reregjistrohet ne Gjykatën e Shkallës së Parë Tiranë, me numur vendimi 4030/1 datë 10.07.2003, konform ligjit të Organizatave Jo Fitimprurëse (OJF)

Që nga krijimi e deri më tani FGE është munduar me përkushtim dhe profesionalizëm të mbrojtë të drejtat e grave duke u fokusuar kryesisht në të drejtën për të qenë e lirë e pa dhunuar dhe në të drejtën për të qenë e barabartë në jetën publike

Na është dashur shumë punë për të bindur gratë sidomos ato që jetojnë në fshat se janë të barabarta me burrat. Ato ishin mësuar në jetën e tyre me dallimin e madh ndërmjet grave dhe burrave. Ato e quanin më se normale që burri mund ti ofendonte, mund edhe ti godiste. Hap pas hapi në shume takime që kemi organizuar me gratë arritëm ti bindim që janë të barabartë me burrat . Fillimisht jemi ndeshur dhe me reaksionin e burrave të cilët mundoheshin të na pengonin në takimet tona .Tek tuk ndigjonim dhe shprehje të tilla” ato duan tju ndajnë nga burrat” Por ne vazhduam punën tonë bindëse, fillimisht vetem me gra / vajza dhe më vonë dhe me burra.

Mbas kaq vitesh ne ndjehemi mirë pasi mendojmë që kemi bërë punë, kemi kontribuar në komunitet për të ndryshuar mentalitete të gabuara në lidhje me gruan dhe pozicionin e saj në familje dhe në shoqëri, kemi kontribuar në ndërtimin e kapaciteteve tek gratë me qëllim që të krijojmë atë shembullin

pozitiv të figurës së gruas në komunitet. Sot ka shumë gra në komunitetin e Elbasanit që janë të gatëshme të marrin shumë përgjegjësi mbi vehte edhe në politikë dhe vendimarrje. Janë me dhjetra gra që janë të denja për të kandiduar si deputete, si kryetare bashkie apo komune. Janë me qindra gra të gatëshme për të qenë antare të këshillave të komunave apo të bashkive, por që akoma burrat që i kanë zënë padrejtësisht vendet e tyre, po rezistojnë dhe nuk po i lëshojnë keto vende

Megjithatë kemi shumë punë për të bërë, sfida të fuqishme na presin në të ardhmen. Forumi i Gruas Elbasan është i vendosur të vazhdojë punën e tij deri në arritjen e treguesve gjinor në të gjitha fushat e jetës

II. Përmbledhja ekzekutive/e përgjithëshme

Shoqata "Forum i Gruas Elbasan" ka filluar aktivitetin e saj në Gusht të vitit 1991, si degë e Forumit të Pavarur të Gruas Shqipëtare. Më vonë në vitin 2000 krijon Forumi i Gruas Elbasan me status juridik me mision kryesor mbrojtjen e të drejtave të grave të grupmoshave, niveleve e besimeve të ndryshme nga zonat urbane e ato rurale, fokusuar kryesisht në të drejtën për të jetuar e lirë pa dhunë dhe në atë për të qenë e barabartë në jetën publike. Organizata ka një eksperiencë disa vjeçare dhe është e vetmja organizatë në rrethin e Elbasanit që mbron vetëm të drejtat e grave. Për të realizuar misionin e saj FGE ka realizuar veprimtari dhe aktivitete të ndryshme me mbështetjen financiare kryesisht të donatorëve të ndryshëm. Aktiviteti i saj këto vitet e fundit është intensifikuar mjaft, kjo e diktuar nga nevojat e grupit të cilit ajo i shërben. Gratë si kudo në botë dhe në Shqipëri kanë qenë, janë dhe fatkeqësisht do të vazhdojnë të jenë edhe për një farë kohe grupi më i marginalizuar. Kemi bërë shumë punë por rezultatet nuk janë ende në nivelin e kërkuar. Për këtë arsye FGE vendosi hartimin e këtij Plani Strategjik, me qëllim që të kishim një drejtim të qartë të lëvizjes sonë. Faktorët e jashtëm gjithashtu po bënin presion mbi organizatën, si largimi i donatorëve, bashkëpunimi me aktor të rinj, niveli ekonomik dhe situata politike, hartimi i një legjislacioni të ri mbështetës për gruan nga njëra anë dhe mungesa dhe moszbatimi disa herë i legjislacionit nga ana tjetër

Me këtë rast një falenderim i vecantë është për të gjithë aktorët që kontribuan në hartimin e këtij dokumenti të rëndësishëm, për kohën që vunë në dispozicion si dhe për profesionalizmin e tyre

Arritja e një vendimi

Forum i Gruas Elbasan e kuptoi se nëse organizata nuk do kishte një drejtim të qartë, nëse njerëzit nuk do kuptonin vizionin, atëherë do ishte e vështirë të vazhdonte veprimtarinë pa një Plan Strategjik (PS). Për këtë arsye ajo mori vendim, hartimin e PS.

PS do ishte një mjet udhëheqës në punën e organizatës, do i jepte asaj drejtimet e së ardhmes duke përcaktuar se çfarë ajo do të arrijë me secilin objektiv. Në të organizata dhe të gjithë të intersuarit do gjenin informacion rreth strategjisë së organizatës.

Gjithashtu eksperiencia disa vjecare e punës së Forumit të Gruas Elbasan na diktoi pasjen e një dokumenti të shkruar ku të tregojmë ku jemi , cfarë kemi bërë, cfarë kemi bërë mirë dhe cfarë kemi bërë keq me qëllim përmirësimin e punës dhe ajo që është më kryesorja ku duam ne të arrijmë mbas disa vitesh dhe të përcaktojmë rrugët, mjetet që do të përdorim për të arritur me sukses atje. Të gjitha keto ne i analizuam në kontekstin e brendëshëm dhe në atë të jashtëm

Situata aktuale e gruas në përgjithësi ishte një tjetër shtysë që na coi në domosdoshmërinë e hartimit të Planit Strategjik së shoqatë.Kemi vite që punojmë, kemi arritur shumë suksese por përsëri nuk jemi aty ku duhet të jemi, nuk kemi akoma tregues gjinor në shumë fusha të jetës, gratë vazhdojnë të jenë të diskriminuara

Plani strategjik i organizatës është një produkt i cili u përgatit me pjesëmarrjen e një sërë aktorësh dhe me inputet e mbledhura prej tyre. Procesi i përgatitjes së këtij dokumenti kaloi në disa hapa mjaft të rëndësishëm:

Hapi i parë: Organizimi i fokus grupit dhe intervistave mbi veprimtarinë e organizatës.

Qëllimi i fokus grupit dhe intervistave ishte të mbledhesh informacion, opinione dhe ide rreth organizatës dhe të ardhmes së saj. Pytjet që u drejtuan ishin:

1. Kush janë anët e forta të organizatës?
2. Si mund ta bëjmë organizatën më efektive?
3. Kush janë tendencat dhe nevojat e komunitetit që përfaqëson organizata?
4. Kush janë ideta tuaja për prioritete te organizatës për pesë vitet e ardhshme?

Pjesëmarrësit

Ne fillim u hartua një listë e personave të cilët duhet të merrnin pjesë në fokus grupet ose do të intervistoheshin. Para se të hartohet lista u pyeten anëtarët e bordit, stafi se kë do donin të listonin. Në këtë listë u përfshinë persona të cilët me mendimet e tyre do ti sillnin vlerë organizatës tonë, persona të cilët nuk morren pjesë në ritrit, çdo person i cili do ndihej i ofenduar që nuk u intervistua.

Kategoria e personave të cilët u përfshinë në fokus grup ose interviste ishin organizata të tjera, përfaqësues të komunitetit, klient, anëtarë, vullnetar, dhe të tjerë që kishin lidhje me organizatën tone. U intervistuan dhe themeluesit e organizatës.

Hapi i dyte: Ritriti i Planifikimit Strategjik

Qëllimi i ritritit ishte të gjeneronte ide rreth anëve të forta të organizatës, nevojave të komunitetit, mundësitë për të ardhmen, vizioni dhe prioritetet. Paketa e ritritit përfshiu informacion rreth organizatës, ambjenti, tendencat dhe fokus grupet dhe përmbledhje e intervistave.

Pjesëmarrës në ritrit ishin të gjithë anëtarët e komitetit të planifikimit strategjik, disa anetarë nga bordi, vullnetarët më aktiv, dhe gjithë stafi.

Paketa e ritritit

Si theksuam më sipër pjesë e paketës ishin informacionet rreth organizatës, përmbledhja e fokus grupit dhe intervistave. Informacione të tjera shtese si:

- Misioni;
- Historia e organizatës ose fazat kryesore të zhvillimit;
- Një faqe përshkrim për secilin program/shërbim të realizuar, buxheti dhe burimi i fondeve, numri i individëve që ju është shërbyer, dhe çdo zhvillim dhe tendencë e veçantë;
- Një çast me historinë e të ardhurave: burimi i të ardhurave dhe shuma;
- Buxheti i tre viteve të fundit, të ndara me kategori;
- Informacion rreth ambjentit- tendencat dhe çështjet;
- Nëse egziston një plan strategjik i mëparshëm.

Hapi i trete: Draftimi i Planit Strategjik

Grupi i punës i caktuar për hartimin e planit strategjik draftoi dokumentin përkatës duke shfrytëzuar të gjitha materialet e dy hapave të parë.

Hapi i katërt: Paraqitja e draftit të Planit Startegjik bordit të organzatës

Bordi pasi u njoh me dokumentin dha konsideratat e tij dhe bëri sygjerimet përkatëse.

Hapi i pestë: Plani Strategjik

Grupi i punës reflektoi në dokument sygjerimet e bëra nga bordi dhe i paraqiti dokumentin përfundimtar bordit dhe drejtorit egzekutiv të organizatës për të filluar zbatimin sipas planit të punës.

Ky dokument është rezultat i këtij procesi dhe përmban planin e FGE për tu angazhuar në pesë vitet e ardhëshme.

Me këtë rast dua të falenderoj të gjithë ata që bënë të mundur realizimin e këtij dokumenti mjaft të rëndësishëm për organizatën tonë, dokument i cili do ta udhëheqi atë në pesë vitet e ardhëshme.

Një falenderim i veçantë shkon për të gjithë ata që kontribuan në realizimin e këtij dokumenti mjaft të rëndësishëm për organizatën tonë dhe për komunitetin të cilit ai ju shërben.

1. Shpresa Banja, Presidente e Forumit të Gruas Elbasan dhe Koordinatore e Projektit “Qendra e Këshillimit për Gratë dhe Vajzat e Dhunuara dhe Studio Avokatore”
2. Dhoksi Quku, Sekretare e OJF dhe Këshilluese në Qendrën e Këshillimit të Grave dhe Vajzave të Dhunuara
3. Evis Garunja, Avokate në Studion Avokatore Elbasan
4. Merjona Çeço, Juriste në Studion Avokatore Elbasan
5. Mimoza Malushaj, As.Administratore në Qendrën e Këshillimit të Grave dhe Vajzave të Dhunuara dhe Studio Avokatore”

Falenderojmë dhe gjithë aktorët e tjerë Studentë dhe pedagogë të Universitetit “Aleksandër Xhuvani”, të Fakulteteve Punë Sociale, Psikologji, Gazetari, Gjuhë e Huaj, Donator, Pushtetin lokal, grupe grash të cilët me opinionet e tyre të vlefshme mbi veprimtarinë e organizatës kontribuan që të hartohet një dokument që do t’shërbejë realisht nevojave të komunitetit.

III. Misioni dhe Vizioni i organizatës

Misioni

- ✚ Mbrojtja e të drejtave të grave, përfaqësimi i tyre ligjor përpara organeve të drejtesisë, ngritja e studios avokatore për ofrimin e asistencës juridike dhe përfaqësimin ligjor të grave dhe vajzave.
- ✚ Rritja e vetëdijes së tyre për rolin dhe të drejtat që kanë në shoqëri dhe familje nëpërmjet fushatave sensibilizuese.
- ✚ Kundërshtimi i të gjitha formave të dhunës të ushtruara mbi to, hapja e qendrave të këshillimit për gratë dhe vajzat e dhunuara.
- ✚ Mbrojtja e jetës së gruas nga dhuna ekstreme dhe ngritja e qendrave të strehimit të perkohshëm te tyre.
- ✚ Edukimi dhe mbrojtja e të drejtës së riprodhimit, shëndetit të nënës dhe fëmijës dhe planifikimi familjar.
- ✚ Nxitja dhe përfshirja e grave në ekonominë e tregut nëpërmjet inkurajimit dhe krijimit të shoqërive të ndryshme të grave me mjetet e tyre apo nëpërmjet fondeve të dhuruara shoqatës dhe fondeve të projektit.

Vizioni

Mbrojtja, garantimi dhe promovimi i gruas në jetën shoqërore

IV. Pikat unike të organizatës Forumi i Gruas Elbasan

- ✚ FGE është qendra e vetme në nivel lokal që bazohet në çështjet dhe në problemet e grave.
- ✚ FGE ka eksperiencë të gjatë për të drejtat e grave.
- ✚ FGE ka paketë cilësore shërbimesh (informim, menaxhim, trajnime, konsulenca etj).
- ✚ FGE ka partneritet me OJF-të lokale në të gjithë Rrethin e Elbasanit dhe me pushtetin vendor.
- ✚ FGE është pjesë e disa rrjeteve kombëtare dhe ndërkombëtare të grave për dhunën ndaj grave dhe ndaj problemeve gjinore.
- ✚ Organizatë e besueshme, e paanshme, staf me eksperiencë profesionale, me raporte të mira me institucione dhe donatorët.

V. Profili i Organizatës dhe historia e saj

Shoqata “Forumi i Gruas Elbasan” është krijuar në Gusht të vitit 1991 si degë e Forurit të Pavaruar të Gruas Shqipëtare, reregjistruar në vitin 1995 po si degë e Forurit të Pavaruar të Gruas Shqipëtare, dega Elbasan.

është regjistruar si shoqatë më vete më 07.01.2000 me vendim 4030 të Gjykatës Rrethit Elbasan dhe reregjistruar me datë 10.07.2003 me vendim nr 4030/1 të Gjykatës së Rrethit Tiranë, konform ligjit të Organizatave jo Fitimprurëse në Shqipëri. Në bazë të statutit, organizata quhet “Forumi I Gruas Elbasan” Mund të njihet dhe si FGE (akronimi). Organizata është formuar si shoqatë me anetarësi. Veprimtarinë e saj organizata e shtrin në Qarkun e Elbasanit, me të drejtë për tu shtrirë në të gjithë Shqipërinë

Profili specifik i organizatës është se bazohet në çështjet dhe në problemet e grave veçanërisht ato me probleme dhune, të grupmohave, niveleve e besimeve të ndryshme nga zonat urbane e ato rurale si dhe në rritjen e pjesëmarrjes së gruas në jetën publike kryesisht në politikë dhe në vendimmarrje Por pjesë e target grupit të organizatës janë dhe meshkujt pasi prania e tyre në problemet e grave e vajzave ndikon në trajtimin, zbutjen e zgjidhjen e problemeve sipas përkatësisë gjinore.

Organizata ka një experiencë të mirë pune për të drejtat e grave, ka kapacitete trajnuese, menaxhuese dhe ofruese konkrete shërbimesh. Këto kapacitete janë krijuar hap pas hapi, vit pas viti duke marrë në konsideratë faktin se organizata i ka dhënë shumë rëndësi trajnimit dhe kualifikimit të stafit.

Në zgjidhjen e problemeve të ndryshme organizata bashkëpunon dhe kooperon me shumë organizata të tjera dhe me qeverinë lokale. Organizata është pjesë e rrjetit kombëtar të grave për dhunën ndaj grave dhe ndaj problemeve gjinore. Si një organizatë lokale bashkevepron dhe me organizata të tjera lokale në Elbasan si psh: Tjetër Vizion, Word Vizion, Në Dobi të Gruas, dhe koordinon mjaft mirë punën së bashku me strukturat e vecanta të qeverisë lokale.

Forumi i Gruas është gjithashtu pikë fokale e WAVE (Qendra Europiane për informim kundër dhunës)

Organizata në fillimet e saj ka pasur vetëm një zyrë të dhënë nga pushteti lokal, e të pajisur thjesht me kontributin e vetë anëtarëve e simpatizantëve të saj. Nuk ka pasur as numër telefoni, fax, kompjuter, fotokopje por vetëm një makinë shkrimi. Tendecat në rritje, ambicja për të ecur para e për ti shërbyer sa më mirë target grupit në realizimin e misionit, bënë të mundur që aktualisht shoqata në saj të projekteve që zbaton ka ambiente me gjithë pasijet e nevojshme për zyra si kompjutera, fotokopje, projektor, flipchart, telefon, Fax, adresë E-maili etj.

Për të forcuar organizativisht e financiarisht shoqatën, në fillimet e saj, si dhe për të rritur nivelin e kërkesave të grave e vajzave, në vitet 1992, 1993, janë hapur kurse për mësimin e gjuhës angleze, frënge e italiane me rreth 140 gra e vajza.

Në mënyrë që të rriteshin të ardhurat në vitet 1993-1995 janë zhvilluar kurse automobilizmi, për patente të grupit "B" me gra vajza e familjare. Organizata që nga krijimi i saj ka patur antarësi cka do të thotë që paguhej edhe një kuotë simbolike nga antarët e shoqatës 50 lekë në vit, ndërsa sot 50 lekë në muaj.

Organizimin e veprimtarive të ndryshme në kuadrin e 8 marsit, apo dhe veprimtari të tjera për gratë, organizata i ka realizuar me sponsorizime nga biznesmenë të ndryshëm të qytetit si dhe anetarë të shoqatës që merren me biznes natyrisht në shuma te vogla 5000 deri 1000 lekë të reja.

Në vitet në vazhdim të ardhurat u shtuan si rezultat i realizimit të projekteve me donator të ndryshëm.

Rritja e të ardhurave bëri të mundur që numri i të punësuarve me kohë të plotë brenda organizatës të rritej. Në fillimet e saj shoqata kishte të punësuar me kohë të plotë vetëm një punonjës, ndërsa sot me kohë të plotë ka 6 punonjës me ekspertiz në fusha të ndryshme që lidhen me problemet e grave.

Organizata ka pasur një veprimtari të gjërë duke:

1. Dhënë shërbime konkrete në favor të grave dhe vajzave;
2. Ngritur fushata sensibilizuese;
3. Organizuar trajnime dhe ngritje kapacitetesh.

1. Shërbime

Në fushën e shërbimeve organizata është fokusuar në dhenien e shërbimeve grave e vajzave të dhunuara nëpërmjet ngritjes së:

Qendres së Këshillimit për Gra dhe Vajza të Dhunuara Elbasan

Kjo qendër ka filluar shërbimet e saj që nga 1.10.1999. në ndihme të grave dhe vajzave me probleme të dhunës të ushtruar ndaj tyre në familje dhe shoqëri. Qëllimi i qendres është te japë:

- ✚ Mbeshtetje emocionale për grate dhe vajzat viktime të dhunës;
- ✚ Informacion juridik dhe mjekësor;
- ✚ Asistencë dhe trajtim psikologjik.

Këto shërbime ofrohen nga një staf mjaft i përgatitur dhe mirë trajnuar për punën me këtë kategori grash dhe vajzash. Stafi përbëhet nga 3 mjekë, 3 psikologe, 4 punonjese sociale dhe 2 juriste që ofrojnë një ndihmë të specializuar për klientët.

Shërbimi ofrohet çdo ditë nga ora 8:00 në mëngjes deri në orën 19:00 pasdite nga e Hëna në të Premte, nëpërmjet linjës telefonike dhe këshillimeve ballë për ballë.

Qëndrës së Këshillimit për Gra dhe Vajza të dhunuara në Cërrik.

Eshtë hapur në janar 2001 dhe ofron shërbime në fushën psikologjike, mjeksore e juridike. Shërbimi behet çdo ditë nga e Hëna në të Premte nga ora 9:00 në mëngjes deri në orën 13:00 të drekes.

Studios avokatore për gra dhe vajza të dhunuara.

Eshtë hapur në 1 dhjetor të vitit 2002, ofron shërbimin e saj çdo ditë nga e Hëna në të Premte nga ora 8:00 deri në ora 16:00. Kjo studio iu vjen në ndihmë ligjore të gjitha grave dhe vajzave me probleme të dhunës së ushtruar ndaj tyre dhe që nuk kanë mjete financiare për ti përballuar ato. Në këtë studio:

- ✚ Ofrohen konsulencë juridike falas;
- ✚ Asistencë juridike dhe mbrojtje ligjore falas ;
- ✚ Perfaqesim në gjykatë nga një avokate falas.

1. Fushata sensibilizuese

Organizata ka organizuar një seri fushatash sensibilizuese për çështjet e grave. Ajo ka organizuar:

- ✚ Në mënyrë individuale kontakte direkte me gra e vajza që vijnë tek ne, që marrin pjesë në veprimtaritë tona.
- ✚ Në grup takime me grupe grash dhe vajzash ose dhe me grupe mikse (të përziera meshkuj dhe femra)
- ✚ Bashkëbisedime midis grave dhe vajzave, përfitueseve të shërbimeve, të cilat përhapin idetë dhe informacionin mbi shërbimet, të drejtat, mënyrat e ndërhyrjes duke realizuar metodën e sensibilizimit zinxhir.

- ✚ Shpërndarje në të gjithë rrethin e Elbasanit dhe më gjere të materialeve promocionale si Fletë-Palosje, Postera si dhe botimeve të tjera.
- ✚ Fushata në median elektronike, me anë të emisioneve televizive, të spoteve etj

2. Trainime

Organizata ka organizuar trainime me aktorë të ndryshëm dhe për tema të cilat kanë pasur në qëndër problemet e grave.

- ✚ Trajnimi i forcave të policisë për nocionet e barazisë gjinore dhe mënyren e trajtimit të rasteve të grave të dhunuara.
- ✚ Trajnimi i punonjësve të administratës publike të bashkisë dhe prefekturës dhe të punonjësve të Gjendejve Civile në lidhje me Normat e reja ligjore të Kodit të Ri të familjes.
- ✚ Trajnimi i grave dhe vajzave me probleme të dhunës në qytetin e Cërrikut dhe aftësimi i tyre profesional për rrobaqepësinë.
- ✚ Trajnimi i grave anëtare, aktiviste të forcave politike dhe potenciale për kandidatë të ardhëshme për këshilltare lokale, deputete, për aftësimin e tyre për lidërshpin dhe pjesëmarrjen në politike.
- ✚ Trajnimi i drejtuesve të forcave politike për barazinë gjinore, rolin dhe të drejtat e grave në politike dhe vendimarrje, etj.
- ✚ Trajnim me mësuesit e shkollave të mesme për rritjen e rolit të shkollës në parandalimin e trafikimit.
- ✚ Trajnim me 54 gra e vajza përfaqësuese të forcave të ndryshme politike, për ti aftësuar si kandidatë të mundshme për këshilltare apo kryetare komune e bashkie.
- ✚ Trajnimin e këshilltareve lokale për ligjin e ri të dhunës në mardhëniet familjare dhe për Stategjine Kombëtare kundër dhunës në Familje

Organizata e kryen këte veprimtari të gjere më një staf të kualifikuar dhe mjaft të dedikuar. Në fillimet e saj shoqata ka pasur të punësuar me kohe të plote vetëm sekretaren e shoqatës. Sot ne sajë të projekteve që realizon ky numër është ne rritje Vetëm në projektin e qëndrës së këshillimit dhe studios avokatore stafi me kohë të plotë përbëhet nga 4 persona , më kohë të pjesëshme 13 persona, nga të cilet 1 kordinatore dhe 12 këshilluese. Stafi me kohë të plotë edhe ai me kohë të pjesëshme , shquhen për aftësitë e tyre kualifikuese. Ato janë te profesioneve të ndryshme si psikologe , pedagoge, mjeke, juriste etj. Aftësitë e tyre kanë ardhur në rritje duke marrë pjese në shumë trenime si:

- ✚ Manaxhimi financiar në Shoqatat Joqeveritare Shqiptare;
- ✚ Trajnim i Përparuar i Drejtuesve të OJQ-ve dhe Krijimi i një Rrjeti Informacioni në Shqipëri;
- ✚ Menaxhimi i Projektit nga Ideja në Zbatim;
- ✚ Trajnim I Avancuar mbi Cështjet e Përkatësise Gjinore”;

- ✚ Trajnim për “Operator Social”;
- ✚ Trajnim trajnerësh “Gruaja Mund T’ia Arrijë”;
- ✚ Trajnim trajnierësh “Barazia Gjinore dhe Të Drejtat e Gruas;
- ✚ Trajnim trajnerësh dhe rritja kapaciteteve të OJF-ve Zhvillimit dhe aplikimi i modelit të veprimëve të kordinuara për luftën kundër dhunës në familje. Aplikimi
- ✚ Për dhunën në familje e si punohet me gratë e dhunuara; i modeleve te kërkimit për dhunën seksuale;
- ✚ Roli I shoqërisë civile për të luftuar korupsionin;
- ✚ Për menaxhimin Financiar të OJF-ve.

Kanë marrë pjese në trainime, konferenca e vizita per shkëmbim përvoja edhe jashte Shqiperisë si Itali, Bullgari, Maqedoni, Suedi, Greqi., Vjenë, Bruksel,Portugali si dhe në konferenca Ballkanike për gratë në Bullgari, Greqi, në seminarin "Trajtimi i Dhunës Familjare nga Institucionet Shtetërore dhe OJQ-të në Maqedoni”; shkëmbim Përvoja për Mbështetjen ndaj Grave të Dhunuara në Itali, Punën me Gratë e Dhunuara në Suedi, Greqi; konferencë ndërkombëtare në Vjenë, Bruksel, Portugali për dhunën mbi gruan.

Të ardhurat e organizatës kanë qenë në rritje tre vitet e fundit dhe këto të ardhura kanë ardhur nga burime të ndryshme. Mbështetësi kryesor ka qenë Fondacioni Suedeze Kvinna till Kvinna.

Anët e forta të organizatës:

A Bashkëpunimi me pushtetin vendor

1-Marrëveshje e shkruar me Bashkinë Cerrik e Elbasan

2-Anëtarë të Komitetit Rajonal Antitrafik

3-Aktivitete të përbashketa me OJF-te,me komitetin rajonal,me bashkitë.

4-Me pushtetin vendor pjesë në shkrimin e aplikimin e projekteve.

5-Shfrytëzim ambjentesh falas nga ana e pushtetit vendor

6-Shkëmbim informacioni

B-Bashkëpunimi me Universitetin

1-Praktika

2-Promovime me materiale promociionale

C-Bashkëpunimi me policine

1-Shkëmbim informacioni

2-Referim rastesh

3-Asistence juridike,psikologjike

D-Bashkëpunimi me donatorët si ata lokale dhe ata kombetarë.

E-Bashkëpunim me Drejtorinë e Shëndetit Publik, Qarku Elbasan

1-Trajnime

2-Interesim

F- Bashkëpunimi me Drejtorine Arsimore Qarku Elbasan

G-Pjesë e disa rrjeteve kombëtare e ndërkombëtare

Gj-Ekspertizë e vecantë në fushata sensibilizuese.

Mundësitë e organizatës:

- ✚ Krijimi i qendrave të reja të shoqatës në zonat rurale dhe ekzistenca e kordinatorëve lokalë në cdo komunë e rajon;
- ✚ Ekzistenca dhe thithja e ekspertizave dhe kapaciteteve të reja që ekzsistojnë në treg;
- ✚ Ekzistenca e Qëndrave Studentore;
- ✚ Mbështetet moralisht nga antarsia, vullnetarët dhe përfituesit;
- ✚ Marrëveshje bashkëpunimi me pushtetin lokal;

- ✚ Pjese e rrjeteve lokale kombëtare dhe ndërkombëtare;
- ✚ Pjesë e tavolinës teknike të Keshillit të Qarkut për Planin e Përkujdesjes Sociale ;
- ✚ Besueshmëri të donatorët.

VI. Drejtimit strategjike për të ardhmen

Në rrethin e Elbasanit kanë operuar dhe operojnë shumë OJF ndërkombëtare, kombëtare dhe lokale. Numri i OJF ndërkombëtare nga dita në ditë po reduktohet. Disa janë larguar nga Elbasani dhe Shqipëria pasi kanë mbaruar misionin e tyre, disa të tjera janë larguar por kanë krijuar OJF e tyre Shqipëtare dhe bashkëpunojnë ngushtësisht me to Organizata të tilla si UNDP ose PNUD, OSCE, janë larguar vite më parë nga Elbasani. Ato ishin organizata serioze që na ndihmuan shumë me mbështetjen e tyre financiare dhe në ngritjen e kapaciteteve. Disa të tjera si CEFA psh një OJF italiane u largua mbas shumë vitesh qëndrimi në Elbasan mbasi krijuan “Tjetër Vizion” një OJF shqipëtare dhe vazhdojnë të bashkëpunojnë me të pa qenë të pranishëm në Elbasan. Ka OJF të tjera në Elbasan që janë si ndërkombëtare pasi kanë degët e tyre në shume vende të botës si “Word Vision” apo “Terre des Hommes”. Sigurisht këto janë të fuqishme pasi kanë suport financiarë. Përveç këtyre ka OJF që krijohen marrin fonde për një kohë dhe shuhen shumë shpejt.. Të gjithë këto bëjnë që në ta kemi shumë të vështirë për të mbijetuar përballë faktit që donatorët po largohen nga dita në ditë dhe pushteti akoma nuk po merr përsiper suportin financiar dhe logjistik të OJF, pavarësisht detyrimeve ligjore që kanë për të mbështetur financiarisht shërbime të ndryshme që OJF-të afrojnë.

Nga analiza e sektorit të OJF-ve dhe problemet me të cilat përballlet ky sektor në rrethin e Elbasanit, është konstatuar se ka akoma paragjykim mbi sektorin e shoqërisë civile dhe sidomos për ato organizata që merren me problemet e gruas, largim të donatorëve, vakume ligjore, ndryshim politikash, largim të stafit të trainuar, konkurrence e pandershme e individëve dhe OJF-ve.

Nisur nga këto probleme FGE do të përqëndroje të gjithë aktivitetin e saj në të ardhmen në disa drejtime.

- ❖ Mbrojtja e të drejtave të grave nga cdo cënim diskriminues e dhunues me objektiv balancimin gjinor në aspektin shoqëror, social e familjar dhe ngritjen e pozitës së gruas në familje e shoqëri.
- ❖ Rritjen e pjesëmarrjes së tyre në politikë me objektiv sjelljen e një fryme të re inkurajuse e nxitëse për gratë nga forcat politike e komuniteti
- ❖ Aftësimi i grave për të qene lidere e aftë në aktivitete private ,ekonomike, shoqërore dhe politike

- ❖ Sensibilizimi i grave si dhe aftësimi i tyre në përballimin e vështirësive që hasin si nënë, bashkëshorte me objektiv edukimin gjinor në familje.
- ❖ Rritja e bashkëpunimit me pushtetin lokal, në zbatim të Strategjise Kombëtare të Dhunës dhe Planit për Veprim të Qeverisë Shqipëtare si dhe detyrimeve që janë përcaktuar në ligjin për dhunën në familje në mbështetje të OJF-ve që afrojnë shërbime dhe janë të licensuara nga MPCSSHB.
- ❖ Sensibilizimin e opinionit publik për të drejtat e grave dhe përfshirja në këtë sensibilizim edhe e burrave me synim ndryshimin e mentalitetit për të mos dënuar gruan por dhunuesin e shkelsin e të drejtave të saj.
- ❖ Më tepër publicitet për punën e kryer nga forumi si nëpërmjet medias, takimeve të herepashërshme me pjesë të vëcanta të komunitetit ku problemet e grave të jene objekt i i bisedave, emisioneve e debateve të hapura televizive me objektiv rritjen e prezencës së shoqatës në komunitet, institucione shtetërore, për të tërhequr sponsor apo financues të projekteve në ndihmë të komunitetit të gjerë jo vetëm atij femëror.
- ❖ Rritja e target-grupit që do të punohet në të ardhmen, në funksion të mbrojtjes së të drejtave të grave .

Si rrejdhojë e kësaj strategjie ne do kemi më shumë gra që përfitojne nga shërbimet e FGE, më shumë gra të sensibilizuara për rolin e tyre në shoqëri, më shumë gra të trajnuara mbi problemet gjinore dhe të kualifikuara profesionalisht, më shumë bashkëpunim midis OJF-së dhe institucioneve të pushtetit lokal, polici, prokurori, gjykatë, OJF, donatorë dhe partnerë të tjerë kombëtare/nderkombëtare, më shumë gra të përfshira në jetën politike dhe publike, më shumë gra të punësuar në sektorin publik e jopublik, të vetepunësuar, më shumë aktivitete social-kulturore për gratë/vajzat për përmirësimin social te jetës së tyre, rritje të numrit të burrave që trajnohen dhe bëhen pjesë e aktiviteteve me bazë gjinore.

Organizata ka bashkëpunuar me donatorë të ndryshëm, institucione publike, shoqata të ndryshme lokale, kombëtare dhe nderkombëtare.

Donatorët me të cilët kemi bashkëpunuar më shumë janë :

KVINNA till KVINNA /Sida- donator strategjik

- ❖ Ka mbështetur një konference 2 ditore me temë: “Shoqëria Civile dhe Qeveria kundër dhunës ndaj gruas” në Nëntor 2000 dhe një tjetër konferencë në Nëntor 2003
- ❖ Në vitin 2002 e deri më tani Kvinna Till Kvinna mbështet Qendrën e Këshillimit për Gra dhe Vajza me probleme dhune në qytetin e Elbasanit dhe në atë të Cerrikut si dhe Studion Avokatore në Elbasan

Qeveria e Shteteve të Bashkuara të Amerikes

Ka mundësuar realizimin e projekteve:

- ❖ Situata e trafikimit në Distriktin e Elbasanit dhe edukimi i komunitetit për të luftuar këtë fenomen

- ❖ Fushatë ndërgjegjsuese për gruan në politikë dhe vendimarrje.

- ✚ **REC (Agjensia Rajonale e Mjedisit)**

Ka mundësuar realizimin e projekteve:

- ❖ Ndërgjegjësimi i grupmohave të ndryshme në vecanti i grave për problemin e mbetjeve, të ngurta urbane dhe influenza e tyre

- ❖ Ndërgjegjësim i komunitetit për problemin e mjedisit dhe shëndetit nëpërmjet monitorimeve të realizuara në zonën industriale

- ❖ Reabilitimi i disa zonave nga mbetjet e ngurta urbane dhe rikonstruksioni i lulishtes përpara bibliotekes së qytetit.

- ✚ **SOROS**

Ka mundësuar realizimin e projekteve:

- ❖ Integrimi i grave romë egjiptiane me pjesën tjetër të komunitetit të grave

- ❖ Njohja dhe promovimi i vlerave të përbashkëta të etnive Greke, Rumune, Rome dhe Egjiptiane, inkurajimi për komunikim ndërmjet tyre, roli i gruas në këtë kontekst.

- ❖ Fushatë sensibilizimi mbi Kodin e ri të Familjes dhe trajnimi i punonjësve sociale dhe të zyrave të Gjendjeve Civile.

- ✚ **Bashkia Vjenë dhe HORIZONT 3000**

Ka mundësuar realizimin e projekteve:

- ❖ Ndërgjegjësim i komunitetit për parandalimin e trafikimit të vajzave dhe grave të reja në distriktin e Elbasanit në vitin 2006 e në vazhdim për 2007.

- ✚ **Fondacionit WFD Londer**

Ka mundësuar realizimin e projektit:

- ❖ Pjesëmarrja e gruas në jetën publike

Një pjesë e rëndësishme e punës dhe e suksesit tonë është dhe bashkëpunimi që ne kemi me institucionet shtetërore si me policinë, gjykatën, prefekturën, bashkinë Elbasan dhe Cerrik, Universitetin Aleksandër Xhuvani në Elbasan etj. Me disa nga këto struktura kemi edhe marrëveshje të shkruar bashkëpunimi. Kjo mbështetje nga pushteti lokal ka qenë më tepër morale dhe në disa raste edhe konkrete duke na dhënë pa qera ambiente në bashki, Prefekurëe Qark për veprimtari të ndryshme që ne kemi bërë.

Kjo na ben për të shpresuar që në një të ardhme të shpejtë mbështetja do të jetë dhe financiare pasi shërbimet që ne bëjmë janë mjaft të vlefshme për komunitetin e Elbasanit

Ne dhamë kontributin tonë në mbledhjen e firmave për miratimin e ligjit “ Për masa kundër dhunës në mardhëniet familjare” si dhe kuotës 30% për nivelin e përfaqësimit të grave në strukturat politike e vendimmarrëse. Gjithashtu organizata është përfshirë edhe në inisjativa të tjera locale si Hartimi I Planit Social të Zones, për Bashkinë e Qarkun Elbasan, për studimin e bërë në Qarkun e Elbasanit për Objektivat e Zhvillimit të Mijevjëçarit se dhe studimin për situatën e dhunës në Shqipëri një dokument që I parapriu hartimit të strategjisë kombëtare kundër dhunës në familje.

Ne jemi pjesë e rrjetit kombëtar të grave për dhunën ndaj grave dhe ndaj problemeve gjinore. Si një organizatë lokale ne operojmë me organizatat lokale në Elbasan si psh: Tjetër Vizion, World Vizion, Në dobi të Gruas shqiptare, Karitas, CSDC(Qendra e zhvillimit për shoqërinë civile) etj.

Jemi gjithashtu dhe pjesë e rrjeteve ndërkombetare të tilla si :

- ✚ WAVE- Network & European Info Centre Against Violence (Qendra Europiane e informimit kundër dhunës)
- ✚ IFE-EFI European Feminist Initiative for another Europa
- ✚ NAWO- Connecting Women to Europe

VII. Objektivat strategjike dhe plani i punës

Qëllimi: Promovimi i barazisë gjinore dhe fuqizimi i grave

Objektivi: Eliminimi i pabarazisë në edukimin fillor, nëntëvjeçar e të mesëm

Aktivitetet:

1. Trainim i mësuesve për konceptet gjinore duke krijuar një grup trainerësh
2. Debate të lira me nxënësit e ciklit 9/vjeçar dhe të mesëm për konceptet elementare të barazisë gjinore.

Objektivi: Eliminimi i pabarazisë në frekuentimin nga vajzat dhe djemtë në shkollat fillore, nëntëvjeçare dhe të mesme

Aktivitetet:

1. Fushatë sensibilizuese për frekuentimin e shkollës kryesisht në mediat lokale duke trajtuar tema të ndryshme nga lektorë të ndryshëm
2. Takime me grupe nënash /vajzash për ti bindur për frekuentimin e shkollës duke dhënë argumentat bindës për këtë qëllim
3. Përmirësim i legjislacionit duke e bërë arsimin e mesëm të detyrueshëm
4. Plotësim pyetsorësh dhe evidentim të situatës lidhur me braktisjen e shkollës nga vajzat në zonat rurale dhe bërja e tyre prezent strukturave publike.

Objektivi: Eleminimin e pabarazisë mes burrave e grave në jetën familjare dhe publike

Aktivitetet

- 1.Sensibilizimi i opinionit publik për rolin e gruas.
- 2.Ofrimi i shërbimeve (psikologjike, mjekësore, juridike) falas.
- 3.Kualifikim profesional për gratë/vajzat e të gjitha grupmohave dhe shtrirjeve gjeografike për ti përgatitur për tregun e punës
4. Përgatitje dhe shpërndarje materialesh ndërgjegjësuese për të drejta të barabarta
- 5.Ndërmjetësim midis OJF-ve dhe pushtetit lokal, strukturave të tjera shtetërore (polici, prokurori, gjykatë, shërbimeve sociale shtetërore apo lokale) për rehabilitimin dhe riintegrimin e grave me probleme sociale.
- 6.Nxitja e punësimit të grave nëpërmjet programeve integruese dhe të punësimit për gratë në nevojë në bashkëpunim me strukturat e pushtetit lokal dhe qëndror, biznesit dhe aktorëve tjetër të shoqërisë civile.
- 7.Mbështetja, trajnimi dhe promovimi i iniciativave individuale të grave në jetën publike dhe shoqërore.

Objektivi: Eleminimi i diskriminimit në perfaqësimin në strukturat politike dhe vendimarrëse ose rritja e pjesëmarrjes së gruas në jetën publike

Aktivitetet

1. Inkurajimi e lobimi për përfshirjen, rritjen e numrit të grave dhe kapaciteteve të grave në jetën publike (në institucionet shtetërore publike).
2. Lobim me partitë politike për të përfshirë sa më shumë gra në listat shumëemrore për këshilltare dhe për të nominuar sa më shumë gra për kryetare Bashkie/ Komune në zgjedhjet lokale dhe deputete në zgjedhjet qëndrore
3. Sensibilizimi i opinionit publik për të drejta të barabarta dhe për rolin e gruas në jetën publike
4. Ndërtim kapacitetesh tek gratë për të qenë të afta në rolin e lidershit
5. Trainim të partive politike për konceptet gjendër dhe për futjen e këtyre koncepteve në statutet e tyre dhe në praktikën e përditëshme të punës
6. Nxjerrjen e grave më të afta nëpërmjet pyetesorëve të plotësuar në komunitet dhe të sygjera tek partitë politike
7. Monitorim i situatës aktuale për pjesëmarrjen e femrës në stukturat e vendimarrjes vendore e parë në kontekstin gjinor dhe bërja e tyre publike.
8. Mbështetje të grave kandidate për deputete, kryetare bashkie, komunë, pavarësisht përkatësisë partiake.

Indikatorë:

1. Rritja e nr. të vajzave që ndjekin arsimin nëntëvjecar e të mesëm
2. Rritja e nr të grave, vajzave dhe burrave të sensibilizuar për të drejtat e grave në familje e shoqëri
3. Rritja e nr të grave të angazhuara në strukturat politike dhe vendimarrëse

Qellimi: Të përmirësohet statusi i grave përsa i përket dhunës në familje

Objektivi: Diversifikim të shërbimeve ekzistuese dhe zgjerim të tyre

a-juridike

b-psikologjike

c-mjekësore

Aktivitetet:

1. Shkrim projektesh me qëllim punësimin e grave me probleme dhune dhe kryefamiljare në shërbime të tilla si –shërbime babysiter, kujdesje për moshat e avancuara me personel si dhe ato me probleme fizike, shërbime në familje (pastrim, kopshtari)
2. Hapje e një qendre informimi brenda universitetit si pikë fokale për të dhënë informacion dhe për të shpërndarë materiale sensibilizuese për dhunën në familje, shërbimet që afrohen në fushë nga institucione publike dhe jo publike, legjislacioni kombëtar dhe ndërkombëtar në mbrojtje të grave me probleme dhune etj
3. Ngritja e strukturave të reja në zonat rurale që do të kenë të njëjtat funksione informuese, orientuese për gratë me probleme dhune dhe njëkohësisht do të jenë ura

lidhëse ndërmjet nesh dhe strukturave të pushtetit lokal

